



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 105, Datë 31.05.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“KROI MBRET ENERGJI” SH.P.K. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 10, pikat 1 dhe 3, dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1028/2 prot., datë 29.05.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k. me shkresën nr. 1028/1 prot., datë 23.05.2024 ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në nenin 16, pika 1 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 456 Seria T19, është 02.12.2024).
- Shoqëria ka paraqitur aplikimin e saj në datën 23.05.2024, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, gërmat “a” dhe “b” si dhe nenin

16, pika 7, por në kuadër të një dosje të plotë aplikimi, shoqëria duhet të informojë në lidhje me sa më poshtë:

Neni 16 Rinovimi i licencës

Formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1

- **gërma “c”**: (deklarata të aplikuesit): Subjekti ka përcjellë të plotësuar vetëm pikat “a” dhe “b” të Shtojcës 1, por mungon dokumentacioni i kërkuar sipas pikës 1/c. Në vijim do t’i kërkohej subjektit të depozitohet edhe Shtojcën 1/c.
- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 456, Seria T19, të shoqërisë “KROI MBRET ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 02.12.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI